



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 974/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu në çështjen përmbartimore të kreditorit “O...G...” me seli në Graz – Austri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e I...A... LLC me seli në Prishtinë, Lagja ... Blloku ..., me avokat B.N., ndaj debitorit Kompania e Sigurimeve “S...” Sh.A., me seli në Rr. ... Nr. ..., Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Kompania e Avokatëve ... me seli në Prishtinë, Rr. ... Nr. ..., (...), duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1683/20 i datës 09.12.2020, të Përmbartuesit Privat Eset Murati me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 31.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Kompania e Sigurimeve “S...” Sh.A., ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.1683/20 i datës 09.12.2020 i Përmbartuesit Privat Eset Murati dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Eset Murati me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “O...G...” me seli në Graz, Austri, ka caktuar urdhrin P.nr.1683/20 të datës 09.12.2020, duke lejuar përmbartimin në bazë të marrëveshjes / ujdisë së datës 04.08.2020, për shumën e borxhit në vlerë 25,416.71 €, me kamatë vonesë 8% duke e llogaritur nga data 03.11.2020 e deri në datën e përlllogaritjes nga eksperti financiar për shumën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kontestuar propozimin e kreditorit duke theksuar se propozimi për përmba rim është i kundërligjshëm dhe është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e neneve 21, 22 dhe 29 të Ligjit për Procedurën Përmba rimore, duke shtuar se ujdia jashtëgjqësore nuk është dokument i përmba rueshëm / nuk është titull ekzekutiv sipas ligjit, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që të aprovojë si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të anulojë në tërësi urdhrin përmba rimor P.nr.1683/20 të datës 09.12.2020, i nxjerrë nga përmba ruesi privat Eset Murati.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmba rimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmba rimor duhet të anulohet dhe procedura përmba rimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Marrëveshja / Ujdia Jashtëgjqësore e datës 04.08.2020, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmba rim, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 22 të LPP-së, për tu konsideruar si dokument përmba rues.

Sipas nenit 22 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokumente përmba ruese janë: 1.1. vendimi përmba rues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmba ruese; 1.2. vendimi përmba rues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia); 1.3. dokumenti noterial i përmba rueshëm në pajtim me ligjin për noterinë; 1.4. marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit ne pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës; 1.5. aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujditë gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujditë e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmba rim brenda territorit të Republikës së Kosovës; 1.6. vendimet dhe marrëveshjet përmba ruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata; 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe*

regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit; 1.8. vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbarues evropian; 1.9. dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarues”

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se marrëveshja/ujdia e datës 04.08.2020 e lidhur ndërmjet Kompanisë së Sigurimeve “S...” dhe O...G..., në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbarim të përcaktuara me dispozitën e nenit 22 të LPP-së, meqenëse një marrëveshje e tillë nuk është e përcaktuar si dokument përmbarues në bazë të së cilës mund të kërkohet realizimin i kërkesës në procedurë përmbarimore.

Meqenëse në rastin konkret urdhri me të cilin është lejuar përmbarimi mbështetet në një dokument i cili sipas dispozitës së lartcekur, nuk është dokument përmbarues, gjykata gjeti se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi

Nga sa u tha më lartë, Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.974/22, datë 31.03.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale me seli në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.